



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 473/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina- Referues, z. Goran Milenković – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “As Tech” sh.p.k- Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE: z.Sabri Azemi B.I- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja e kondicionerëve ne objektin e Komunës dhe institucioneve tjera Komunale” me nr. te prok: 19-4043-221, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/-Komuna Prishtinës, më datën 15.08.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “As Tech” sh.p.k Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja e kondicionerëve ne objektin e Komunës dhe institucioneve tjera Komunale” me nr prok: 19-4043-221, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/-Komuna Prishtinës.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës me titull: “Mirëmbajtja e kondicionerëve ne objektin e Komunës dhe institucioneve tjera Komunale” me nr prok: 19-4043-221, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/-Komuna Prishtinës, dhe lënda kthehet në **Ri-vlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “As Tech” shpk aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 13.06.2019

Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave është bërë me dt: 10.07.2019

Data e njoftimit me letër standarde është bërë me dt: 16.07.2019

Data e njoftimit mbi vendimin e AK-B58 është bërë me dt: 16.07.2019

Data e hapjes së ofertave është bërë me dt: 05.07.2019

Data e kërkesës për rishqyrtim është bërë me dt: 19.07.2019

Autoriteti Kontraktues me dt: 22.07.2019, ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim.

Operatori ekonomik ankues “As Tech” sh.p.k Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 01.08.2019 me nr. 473/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Mirëmbajtja e kondicionerëve në objektin e Komunës dhe institucioneve tjera Komunale” me nr prok: 19-4043-221, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/-Komuna Prishtinës, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59, 60, 66, dhe 56 të Ligjit të Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 02.08.2019 ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 06.08.2019, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues: “As Tech” sh.p.k Prishtinë, në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të këtij aktiviteti të

prokurimit, konstaton si në vijim:

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se OE nuk ka sjelle dëshmi te mjaftueshme se ka përfunduar kontrata te natyrës se ngjashme ne 3 vitet e fundit prej momentit te publikimit te njoftimit për kontratë. OE i është lëshuar referenca nga menaxheri i projektit se ka përfunduar kontratën ne tetor të vitit 2017, ndërsa ne kohen kur është lëshuar referenca kontrata ka qene ende aktive, madje OE ka kryer shërbime edhe ne vitin 2018, nga kontrata e njëjtë.

Gjithashtu, duke marr për baze kërkesën nga AK nenin 9.1 & 9.2 të FDT-së, tek Kapaciteti teknik dhe profesionale po citoj: *“OE-ik duhet te ofroj dëshmi te mjaftueshme se ka realizuar kontrata te ngjashme ne tri vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimi te njoftimit në vlerën minimale prej 50,000.00€.*

Dhe dëshmia e kërkuar:

1. Lista e projekteve të përfunduara në tri vitet e fundit për kontrata te ngjashme dëshmuar me kopjet e referencave apo certifikatave te pranimeve, duke plotësuar Aneksin 6.”

Eksperti shqyrtues lidhur me këtë pretendim mendon/sqaron se OE i rekomanduar për kontrate nga AK ne dokumentet e tenderit te ofertës se tij nuk ofron dëshmi se e plotëson kërkesën e AK, pasi ne listën kontratave te realizuar si dhe ja ka bashkëngjit Referencën për këtë projekt me titull: Furnizimi dhe mirëmbajtja e kondicionerëve ne objektin e Komunës se Prishtinës, me numër: 616 16 134 121 duke prezantuar vlerën prej: 42,918.45 €, mirëpo bazuar ne shkresën e OE ankues te datës 25.07.2019 drejtuar Komunës Prishtinës – Kërkesë për qasje ne dokumentacion publik, sistemin e pagesave lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizimi dhe mirëmbajtja e kondicionerëve ne objektin e Komunës se Prishtinës me nr. 616 16 134 121, janë prezantuar faktuara se bashku me raporte te pranimi nga Komuna e Prishtinës për vitin 2016 ne vlere: 21,219.00 €, për vitin 2017 ne vlere: 30,722.00 € dhe për vitin 2018 ne vlere: 3,610.00 €, d.m.th. ne vlere totale arrin 55,551.00 €. Duke pas parasysh se kjo kontrate është nënshkruar me Komunën e Prishtinës me date 12.10.2016 për një periudhe prej 36 muajsh, si dhe tek kontratat kornize secila urdhër-blerje e lëshuar nga autoriteti kontraktues është kontratë ne vete, konsideroj se OE i rekomanduar për dhënie te kontratës e plotëson këtë kriter, mirëpo AK ka mundur te kërkoj sqarime nga OE i rekomanduar për dhënie te kontratës apo/ose sqaroj dhe te argumentoj apo bind OE ankues se OE i rekomanduar për dhënie te kontratës e plotëson këtë kriter sipas FTD-së. Duke u bazuar në këto fakte dhe duke pas parasysh analizën e mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë është pjesërisht i qëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se Kontrata: “Servisimi, pastrimi i filtrave te ajrit dhe mirëmbajtja e filtrave ne objektin e ri Komunal” me nr. prok. 616 15 288 236 e prezantuar ne Aneksion 6 nga OE i rekomanduar për dhënie te kontratës, ku figuron se kontrata ka zgjate një vit dhe data e përfundimit është viti 2017, ndërsa realisht kontrata ka përfunduar për 20 dite dhe ne muajin Prill 2016 është lëshuar referenca nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimi, po ashtu kjo reference nuk mund te pranohet sepse ka te beje me një kontrate qe ka përfunduar para me shume se 36 muaj e fundit.

Gjithashtu, duke marr për baze kërkesën nga AK nenin 9.1 & 9.2 të FDT-së, tek Kapaciteti teknik dhe profesionale po citoj: *“OE-ik duhet te ofroj dëshmi te mjaftueshme se ka realizuar kontrata te ngjashme ne tri vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimi te njoftimit në vlerën minimale prej 50,000.00€.*

Dhe dëshmia e kërkuar:

1.Lista e projekteve të përfunduara në tri vitet e fundit për kontrata te ngjashme dëshmuar me kopjet e referencave apo certifikatave te pranimeve, duke plotësuar Aneksin 6.”

Eksperti shqyrtues lidhur me këtë pretendim mendon/sqaron se kjo kontrate e prezantuar ne Aneksi 6 nga OE i rekomanduar për dhënie te kontratës është jashtë periudhës ne tri vitet te fundit duke filluar nga data e planifikimit te njoftimit për kontrate, duke pas parasysh se kjo kontrate është nënshkruar me date 16.02.2016 me një afat prej 12 muajsh, por tek neni 2 Lënda po citoj: sipas specifikimeve teknike dhe detyrave qe janë pjesë e kësaj kontrate ne afat prej 20 dite” , gjithashtu autoriteti kontraktues Komuna e Prishtinës – Departamenti i Prokurimit lëshon referencën me date 28.04.2016 ne te cilën thotë ka kryer shërbimet me suksese qe do te thotë kjo kontrate është e përfunduar .Duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë është pjesërisht i qëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK nuk ka kërkuar sqarime për çmimet a normalisht te ulëta te disa pozicioneve te dhëna ne para masë si p.sh.: Pozicioni 2. Furnizimi dhe montimi i klimës split BTU 9000 R410 me çmim 110 euro, ndërsa çmimi i blerjes për këtë pajisje është 200 euro, pastaj Pozicioni 6. Furnizimi me kondicioner kanalor ngrohje 65000/ftohje 60000, Btu/h me çmim 250 euro, ndërsa çmimi i tregut është te paktën 1500 euro. OE ka bere manipulim me çmime, përparësia e ekzekutimit te kontratës se kaluar dhe marrja e informacioneve se cilat pozicione janë me te kërkuara nuk arsyeton dhënien e çmimit ab-normalisht te ulet dhe nuk mund te pranohet i tille nga Komisioni i vlerësimit për këtë tender.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, bazuar ne nenin 4.2 Procedura e shqyrtimit

(interpartes)në Rregulloren për tender Jo-Normalisht të Ulët, po citoj: *“Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit) duket të jetë ab-normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë jo-normalisht i ultë, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshinë një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët".*

Eksperti shqyrtues sqaron se konforme nenit 61 të LPP-se, përkatësisht paragrafit 2 të nenit 4 të Rregullores për çmime Jo-Normalisht të ulëta, AK-ja ka mundur të trajtoj si çmime ab-normalisht të ulëta dhe të zhvilloj të gjitha procedurat (*InterPartes*) për çmimet për të cilat ka mundur të dyshoj se janë çmime Jo-Normalisht të ulëta duke krahasuar me manualin e çmimeve refrenet të nxjerr nga KRPP-ja, kontratat e lidhur më parë nga Komuna e Prishtinës apo/ose duke analizuar çmimet e tregut.

Gjithashtu, Eksperti Shqyrtues sqaron si ne vijim: Është përgjegjësi, dhe ne diskrecion të Autoritetit Kontraktues respektivisht e komisionit të vlerësimit që gjatë procesit të vlerësimit të tenderuesve, të trajtoj dhe analizoje çmimin, apo të konsiderohet si jo normalisht i ultë në pajtim me nenin 61 të LPP-së, në mënyrë që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, specifikimeve teknike të kërkuara në Aneksi 1, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kriterëve të vendosura dhe rregullave ku janë të publikuar në ueb-faqen e KRPP-së, në formularin B57.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se autoriteti kontraktues nuk është përgjigjur fare në kërkesën për rishqyrtim lidhur me pretendimin tone, çmimet jo-normalisht të ulëta, Eksperti shqyrtues sqaron se duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit sqaron se autoriteti kontraktues – Departamenti i Prokurimit në vendimin me datë 22.07.2019, Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim tek pjesa e Arsytimit nuk i përgjigjet fare OE ankues edhe përkundër faktit se OE ankues tek deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet ngrit pretendimin mbi çmime jo-normalisht të ulëta për pozicionin 2 dhe pozicionin 6. AK ka qenë i obliguar të përgjigjet në të gjithë pretendimet e OE ankues duke arsyetuar vendimin e vet duke u bazuar dispozitat ligjore të LPP-së. Andaj sqaroj se nuk është respektuar neni 108/A par, 12 i LPP-së po citoj: *“Kundërshtimet dhe vendimet e miratuara në përputhje me paragrafët 8 dhe 10 të këtij neni, duhet të jenë të arsyetuara dhe të komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë”*. Duke u bazuar në këto fakte dhe analizën se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë janë të qëndrueshëm.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara qe te sigurojnë qe fondet publike dhe burimet publike te përdoren ne mënyrën me ekonomike, njëkohësisht duke marr ne konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit ashtu siç parashihet ne nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi qe dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën me efikas, me transparent dhe me te drejt te shfrytëzimit te fondeve dhe burimeve publike.

Eksperti shqyrtues profesional, duke u mbështetur në ekzaminimin e fakteve të prezentuara në dosjen e tenderit, raport, si dhe rrjedhën nga ana e AK-së, në ankesa e OE: "ASTech" Sh.p.k. për tenderin e AK: Komuna e Prishtinës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:"Furnizimi dhe mirëmbajtja e kondicionerëve ne objektin e Komunës dhe institucioneve tjera Komunale",me nr. prokurimi: 615-19-4043-1-2-1, rekomandon që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht të bazuara, (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimet si më lartë) dhe të njëjtin tender rekomandojmë autoritetin kontraktues, të anulohet njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe ky aktivitet i prokurimit të kthehet në Rivlerësim.

Operatori Ekonomik ankues përmes parashtresës me shkrim të datës 06.08.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet pjesërisht me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 06.08.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet më raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 15.08.2019 , ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i Autoriteti Kontraktues si dhe eksperti profesional i prokurimit, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues z.Sylejmani deklaroj: Lidhur me referencat dhe kontratat u sqarua, OE ankues ka pretenduar se këto nuk janë te ngjashme lidhur me sistemin e ngrohjes ku OE i rekomanduar ka ofruar një numer te madh, nuk mund te jetë ndryshme Kontrate e ngjashme si mirëmbajtja qendrore ne shkollat e institucioneve, këtë mundemi te dëshmojmë ne kontratën e mëhershme te cilin OE i rekomanduar e ka pasur me KK- Prishtine për pozicionet e caktuar qe drejt për drejt ka te bej me aklimatizim ne poz 54 Furnizimi dhe montimi i Fankolilave qe është identik me AP qe

tani Autoriteti Kontraktues po e zhvillon. Tek kontratat qe po e konteston kontratën e pare, OE i rekomanduar për kontrate e ka plotësuar këtë kusht, ne kontratën tjetër është gabim teknik i Autoriteti Kontraktues dhe është ne vitin 2017, dhe kontrata e fundit urdhër pagesa e datës 30.03.2017 panelit i dorëzon Urdhër pagesat për kontratën Servisimi i filtrave dhe mirëmbajtja e kondicionerëve.

Mendoj qe duhet te sqarohet kjo çështje sepse kemi te bëjmë me furnizim dhe mirëmbajtje te kondicionerëve qe nënkupton se nuk është domosdoshmërisht me kondicioner te ri, edhe po te jete furnizim OE i cili ka realizuar kontrata te me hershme është ne njohuri se sistemi ekzistues.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Mekolli deklaroj: AK Komuna e Prishtinës duke u mbështetë ne te gjitha arsyetimet e dhëna kërkon nga panelit shqyrtues qe ta aprovoj Njoftimin e Vendimit te AK dhe ta hedh si te pabazuar Ankesën e OE ankues “As tech” sh.p.k Prishtinë.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti profesional i prokurimit z. Beqiri deklaroj: Se cilin pretendim e kam sqaruar ne mënyrë te detajuar, duke e par sqarimin e përfaqësuesit te Autoriteti Kontraktues ne pretendimin 2 nuk e keni ber përgjigjen qëndroj prapa raportit te ekspertizës

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së z.Sylejmani deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtuese qe ta aprovoj ankesën tone si te bazuar dhe lënda te kthehet në rivlerësim

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, Paneli shqyrtues edhe konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues profesional te prokurimit konstaton si me poshtë:

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se OE nuk ka sjelle dëshmi te mjaftueshme se ka përfunduar kontrata te natyrës se ngjashme ne 3 vitet e fundit prej momentit te publikimit te njoftimit për kontratë. OE i është lëshuar referenca nga menaxheri i projektit se ka përfunduar kontratën ne tetor të vitit 2017, ndërsa ne kohen kur është lëshuar referenca kontrata ka qene ende aktive, madje OE ka kryer shërbime edhe ne vitin 2018, nga kontrata e njëjtë.

Gjithashtu, duke marr për baze kërkesën nga AK nenin 9.1 & 9.2 të FDT-së, tek Kapaciteti teknik dhe profesionale po citoj: *“OE-ik duhet te ofroj dëshmi te mjaftueshme se ka realizuar kontrata te ngjashme ne tri vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimi te njoftimit në vlerën minimale prej 50,000.00€.*

Dhe dëshmia e kërkuar:

1.Lista e projekteve të përfunduara në tri vitet e fundit për kontrata të ngjashme dëshmuar me kopjet e referencave apo certifikatave të pranimeve, duke plotësuar Aneksin 6."

Paneli shqyrtues edhe konform sqarimeve të ekspertit shqyrtues profesional të prokurimit konstaton se OE i rekomanduar për kontrate në listën kontratave të realizuar ja ka bashkëngjitur Referencën për këtë projekt me titull: Furnizimi dhe mirëmbajtja e kondicionerëve në objektin e Komunës së Prishtinës, me numër: 616 16 134 121 duke prezantuar vlerën prej: 42,918.45 €, mirëpo bazuar në shkresën e OE ankues të datës 25.07.2019 drejtuar Komunës Prishtinës – Kërkesë për qasje në dokumentacion publik, sistemin e pagesave lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizimi dhe mirëmbajtja e kondicionerëve në objektin e Komunës së Prishtinës me nr. 616 16 134 121, janë prezantuar faktuar se bashku me raporte të pranimit nga Komuna e Prishtinës për vitin 2016 në vlere: 21,219.00 €, për vitin 2017 në vlere: 30,722.00 € dhe për vitin 2018 në vlere: 3,610.00 €, d.m.th. në vlera totale arrijnë 55,551.00 €. Duke pasqyruar se kjo kontratë është nënshkruar me Komunën e Prishtinës me datë 12.10.2016 për një periudhë prej 36 muajsh, si dhe tek kontratat kornize secila urdhër-blerje e lëshuar nga autoriteti kontraktues është kontratë në vete, Paneli shqyrtues edhe konform sqarimeve të ekspertit shqyrtues profesional të prokurimit konstaton se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës e plotëson këtë kriter, duke u bazuar në këto fakte dhe duke pasqyruar analizën e mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK nuk ka kërkuar sqarime për çmimet a normalisht të ulëta të disa pozicioneve të dhëna në para masë si p.sh.: Pozicioni 2. Furnizimi dhe montimi i klimës split BTU 9000 R410 me çmim 110 euro, ndërsa çmimi i blerjes për këtë pajisje është 200 euro, pastaj Pozicioni 6. Furnizimi me kondicioner kanalor ngrohje 65000/ftohje 60000, Btu/h me çmim 250 euro, ndërsa çmimi i tregut është të paktën 1500 euro. OE ka bërë manipulim me çmime, përparësia e ekzekutimit të kontratës së kaluar dhe marrja e informacioneve se cilat pozicione janë me të kërkuara nuk arsyeton dhënien e çmimit ab-normalisht të ulët dhe nuk mund të pranohet i tillë nga Komisioni i vlerësimit për këtë tender.

Paneli shqyrtues edhe konform sqarimeve të ekspertit shqyrtues profesional të prokurimit konstaton se duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin në shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, bazuar në nenin 4.2 Procedura e shqyrtimit (interpartes) në Rregulloren për tender Jo-Normalisht të Ulët, po citoj: "Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit) duket të jetë ab-normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkojë me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka

dorëzuar tenderin që duket të jetë jo-normalisht i ulët, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevante të tenderit dhe e cila përfshinë një shpjegim për çmimin e ulët duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët".

Paneli shqyrtues edhe konform sqarimeve të ekspertit shqyrtues profesional të prokurimit konstaton se konform nenit 61 të LPP-se, përkatësisht paragrafit 2 të nenit 4 të Rregullores për çmime Jo-Normalisht të ulëta, AK-ja ka mundur të trajtoj si çmime ab-normalisht të ulëta dhe të zhvillojë të gjitha procedurat (*InterPartes*) për çmimet për të cilat ka mundur të dyshoj se janë çmime Jo-Normalisht të ulëta duke krahasuar me manualin e çmimeve refrenet të nxjerr nga KRPP-ja, kontratat e lidhur më parë nga Komuna e Prishtinës apo/ose duke analizuar çmimet e tregut, por shihet se në rastin konkret AK nuk ka patur dilema se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar me çmime jo normalisht të ulëta.

Gjithashtu është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues respektivisht e komisionit të vlerësimit që gjatë procesit të vlerësimit të tenderuesve, të trajtoj dhe analizoje çmimin, apo të konsiderohet si jo normalisht i ulët në pajtim me nenin 61 të LPP-së, në mënyrë që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, specifikimeve teknike të kërkuara në Aneksi 1, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kriterëve të vendosura dhe rregullave ku janë të publikuar në ueb-faqen e KRPP-së, në formularin B57. Pasi që në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet nga Neni 1 (qëllimi) paragrafi 1.2 i Rregullave për Tender Jo-Normalisht të ulët (citim):

1.2 Në çdo rast , kur ka një prag për tender jo-normalisht të ulët, ndalohet përjashtimi automatik i ofertave jo-normalisht të ulëta pa përdorur një procedurë interpartes me operatorin përkatës ekonomik për shqyrtimin e tenderit i cili konsiderohet nga autoriteti kontraktues si jo-normalisht i ulët.

Paragrafi 3 & paragrafi 4 i kësaj rregullore e përcakton metodën e krahasimit të ofertave me çmim jo normalisht të ulët.

Neni 3 i Rregullores për Tender Jo-Normalisht të Ulët:

3.1 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;

i.i. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;

i.i.i. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

Paneli shqyrtues sqaron se ne seancën dëgjimore për shqyrtim kryesor te mbajtur ne OSHP, OE ankues nuk i ka ofruar panelit shqyrtues asnjë dëshmi dhe provë lidhur me pretendimet se OE i rekomanduar për kontrate i ka çmimet jo normalisht te ulëta.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë konform nenit 7 dhe 59 të LPP-së dhe njëkohësisht është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, e ne këtë rast AK-KK Prishtinë ka vepruar konform këtij neni.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë, e ne këtë rast AK-KK Prishtinë ka vepruar konform këtij neni.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Nuhi Paqarizi



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK - Komuna Prishtinës,
- 1x1 OE- "As Tech" shpk Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.